

## **INFORMACION I PËRMBLEDHUR**

# **MBI LEGJISLACIONIN E ZBATUESHËM NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT PËR LEJET E NDËRTIMIT**



**TIRANË  
KORRIK 2016**

## HYRJE

Informacioni i përfshirë në këtë Përmbledhje synon t'u vijë në ndihmë veçanërisht atyre bizneseve të kontaktuar nga Sekretariati në muajt e kaluar, të cilat kanë ngritur si shqetësim bllokimin e dhënieve të lejeve të ndërtimit në fushat ku ata ushtrojnë aktivitetin e tyre, industri, bujqësi etj. si edhe paqartësinë e tyre në lidhje me kuadrin ligjor të adoptuar. Bllokimi i procedurave të lejeve të ndërtimit ka ndikuar edhe në renditjen negative të Shqipërisë sa i përket raportit të Doing Business 2015. Kjo situatë tashmë duket e tejkaluar nga pikëpamja e kuadrit ligjor pas adoptimit të një sërë akteve nën-ligjore që adresojnë këtë shqetësim, rregullat më kryesore të të cilave janë pasqyruar në këtë Përmbledhje.

Nisur nga sa më sipër dhe me qëllimin për t'ju ardhur në ndihmë të gjithë subjekteve të cilat janë ndërkohë në procedura apo kanë vendosur të fillojnë procedurat për marrjen e një leje ndërtimi, Sekretariati i Këshillit të Investimeve ka përgatitur këtë Përmbledhje.

Prej vitit 2014 në të cilin u miratua Ligji Nr. 107 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe në vijim janë miratuar një sërë aktesh të tjera ligjore dhe nënligjore të cilat kanë krijuar një bazë dhe kuadër të ri sa i përket legjislacionit të zbatueshëm në fushën e zhvillimit urban.

Këto zhvillime dinamike të legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kanë sjellë ndryshime nga njëra anë si në planin e institucional dhe rregullator të nevojshëm për monitorimin dhe zbatimin e tij, ndërsa nga ana tjetër kanë futur koncepte të reja si: parimi i miratimit në heshtje të lejeve të ndërtimit, aplikimi për leje nëpërmjet sportelit të shërbimit me një ndalesë, transferimi i të drejtës për zhvillim etj.

Kjo Përmbledhje ofron në mënyrë sintetike një informacion mbi aktet ligjore dhe nën-ligjore kryesore, rregullat bazë të zbatueshme për procedurat e aplikimit dhe të ndjekjes së lejeve të ndërtimit, mënyrat dhe mjetet e aplikimit për leje ndërtimi, afatet dhe procedurat e zbatueshme që nga momenti i aplikimit, shqyrtimit dhe deri në momentin e pajisjes me leje ndërtimi.

## I

### LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM PËR LEJET E NDËRTIMIT

- **LIGJI NR. 107/2014** “PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT” (I NDRYSHUAR).
- **VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE (VKM) NR. 408 DATE 13.05.2015** “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT” (I NDRYSHUAR).
- **VENDIMI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE (VKM) NR. 271, DATË 06.04.2016**, PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VKM NR. 408.
- **VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE (VKM) NR. 671 DATË 29.07.2015** “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT”.
- **VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE (VKM) NR. 427 DATË 08.06.2016** “MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT”.
- **VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE (VKM) NR. 354 DATË 11.05.2016** “PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM”.
- **VENDIM NR.1 DATË 30.07.2015** I KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT (KKT) “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE QË DO TË NDIQEN NGA AUTORITETET E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE NDËRTIMI DERI NË MIRATIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE”.
- **VKM. NR.283, DATË 01.04.2015** “PËR PËRCAKTIMIN E TIPEVE, RREGULLAVE, KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE PËR PRODHIMIN, RUAJTJEN DHE PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE BLEGTORALE NË TOKË BUJQËSORE”, I NDRYSHUAR;

- **UDHËZIM NR. 1 DATË 13.04.2016** “PËR CAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR REGJISTRIMIN E LEJEVE TË NDËRTIMIT DHE AKTEVE NOTERIALE TË LIDHURA PËR ZHVILLIMIN NË CILËSINË E INVESTITORIT DHE TË PRONARËVE TË TRUALLIT APO TË BLERËSVE/POROSITËSVE TË NJËSIVE INDIVIDUALE, TË OBJEKTIT NË FAZËN E KARABINASË DHE TË OBJEKTIT TË PËRFUNDUAR”.
- **LIGJ NR.115/2015** “PËR NDARJEN ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË RSH” (I NDRYSHUAR).
- **LIGJ 139/2015** “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”.

## II PËRKUFIZIME DHE SHKURTIME

- **“Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)”** është institucion me përgjegjësi planifikimi në kuadër të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
- **“Autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e territorit”** janë Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Kryetari i Bashkisë.
- **“Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT)”** është organ kolegjal që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe kryesohet nga Kryeministri. KKT është autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për llojet e zhvillimit komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit, dhe ato që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësishme kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit, mbi propozimin e ministrisë që mbulon sektorin apo zhvillimin përkatës.
- **“Kryetari i bashkisë”** është përgjegjës midis të tjerash për vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë;
- **“Leje ndërtimi”** është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe i lejimit të punimeve përkatëse.
- **“Leje zhvillimi”** është akti i përcaktimit të kushteve zhvillimore për një parcelë/pronë të caktuar, që shërben si bazë për pajisjen me leje ndërtimi.
- **“Miratim në heshtje”** është akti i përfitimit të së drejtës për zhvillim, kryerje të punimeve apo përdorim të ndërtimit pa marrjen e miratimit nga autoriteti përgjegjës i planifikimit, nëse miratimi ose refuzimi i kërkesës nuk është dhënë brenda afatit të parashikuar nga dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014.
- **“E drejta për zhvillim”** është e drejta ligjore për të zhvilluar një parcelë dhe/ose një zonë, në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit. E drejta për zhvillim është e dallueshme nga e drejta e pronësisë dhe jepet nga autoriteti vendor i planifikimit, që ka kompetencën për të rregulluar përdorimin e tokës në juridiksionin e

tij, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Të drejtat për zhvillim mund të mbahen nga pronari i tokës, të shkëmbehen ose të shiten.

- **“Infrastrukturë publike”** është tërësia e rrjeteve, instalimeve dhe e ndërtimeve ekzistuese ose të parashikuara në territor, si dhe e hapësirave publike, që synojnë realizimin e shërbimeve publike në fushat e transportit, të energjisë, administrimit të ujit, komunikimit elektronik, arsimit, shëndetësisë, administrimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit, administrimit të burimeve natyrore e kulturore, mbrojtjes kombëtare, civile e kundër zjarrit si dhe të tjera fusha të ngjashme në shërbim të publikut. Infrastruktura publike ka karakter kombëtar ose vendor dhe realizohet me investime publike ose private.
- **“Njoftim publik”** është njoftimi paraprak i palëve të interesuara dhe /ose publikut, i kryer në kohë të mjaftueshme, nëpërmjet një ose disa prej mjeteve tradicionale të informimit, me qëllim informimin e palëve të interesuara për kohën, vendin dhe qëllimin e takimit publik, sipas këtij ligji.
- **“Plani i Përgjithshëm Vendor”** zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale, planeve të detajuara vendore dhe lejeve të zhvillimit.
- **“Plan i detajuar vendor”** është dokumenti që detajon përcaktimet e planit të përgjithshëm vendor në nivelin e një ose disa njësive strukturore dhe përcakton kushtet për zhvillimin e një zone përmes lejeve të ndërtimit.
- **“Rregullore e planifikimit”** është rregullore e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, që përcakton rregulla të unifikuara për përmbajtjen dhe strukturën e dokumenteve të planifikimit.
- **“Rregullore e zhvillimit”** është rregullore e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave që përcakton kushtet dhe procedurat e detajuara për zbatimin e instrumenteve të drejtimit të zhvillimit dhe për përmbajtjen, strukturën dhe procedurën e miratimit të dokumenteve të kontrollit të zhvillimit.
- **“Rregullore ndërtimi”** është rregullorja e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, që përcakton normat dhe kushtet teknike bazë të detyrueshme për garantimin e qëndrueshmërisë së strukturave, hapësirave të emergjencës, ndriçimit adekuat dhe ventilimit, ruajtjen e energjisë dhe sigurinë e jetës, në lidhje me objektet e reja dhe ato ekzistuese, për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë dhe mirëqenien e përgjithshme të

banorëve, si dhe për përshtatjen e hapësirave për përdorimin nga persona me aftësi të kufizuara.

- **“Rregullore e Regjistrit”** është rregullore e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave që përcakton strukturën dhe standardet e përbashkëta gjeodezike dhe të GIS-it, rregullat për administrimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave, si dhe detyrimet e autoriteteve publike dhe personave të tjerë fizikë dhe juridikë për sa i përket mirëmbajtjes dhe dorëzimit të dokumenteve dhe të dhënave në Regjistër.
- **“Sistemi elektronik i lejeve”** është baza e të dhënave shtetërore për të gjitha kërkesat dhe lejet, sipas legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, pjesë e Regjistrit të Integruar të Territorit, dhe realizon ndërveprimin e të gjitha subjekteve të përfshira në proces, duke përfshirë aplikuesin, autoritetet përgjegjëse për dhënien e lejeve dhe institucionet publike që kanë detyrimin ligjor të japin informacion apo pëlqim lidhur me kërkesën për leje.
- **“Transferimi i të drejtës për zhvillim”** Ky instrument mund të përdoret sa herë që një autoritet vendor ose qendror kërkon të ruajë territore bujqësore, natyrore dhe monumente kulture nga presioni i zhvillimit, ndërkohë që është i interesuar të kompensojë pronarët e territoreve të tilla për mospërdorimin e tokës së tyre për zhvillim.
- **“GIS”**- Sistemi i informacionit gjeografik.
- **“ZRPP”**- Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
- **“QKB”**- Qendra Kombëtare e Biznesit
- **“DPGJC”**- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

### III APLIKIMI PËR LEJE NDËRTIMI

#### 1. *Procedura e Aplikimit*

- Aplikimi për leje ndërtimi duhet të kryhet përmes portalit të *Regjistrit të Integruar të Territorit*.
- Aplikimi për leje ndërtimi përmban një përshkrim të hollësishëm të punimeve që do të kryhen dhe shoqërohet nga dokumentacioni i plotë ndërtimor, përfshirë projektet e detajuara, të hartuara dhe nënshkruara nën përgjegjësinë e ekspertëve të licencuar.
- Rregullorja e zhvillimit ka detajuar përmbajtjen e formularit të aplikimit dhe listën e plotë të dokumentacionit që duhet të shoqërojë kërkesën për leje ndërtimi.

#### 2. *Shqyrtimi i Aplikimit*

- Autoriteti përgjegjës shqyrton aplikimin për leje ndërtimi sipas **parimit me një ndalesë**, duke bashkërenduar punën me të gjitha autoritetet publike të specializuara që duhet të shprehen në lidhje me aplikimin.
- Autoriteti përgjegjës vendos për lejen e ndërtimit brenda **60 ditëve** nga dorëzimi i aplikimit për leje ndërtimi. Rregullorja e zhvillimit mund të përcaktojë afate më të shkurtra apo procedura të diferencuara për pajisjen me leje ndërtimi, për punime me impakt të ulët në territor apo për investime strategjike për vendin.
- Në rast se autoriteti përgjegjës nuk merr vendim brenda afatit të mësipërm dhe struktura përgjegjëse e planifikimit pranë autoritetit vendor nuk ka dhënë mendim negativ lidhur me kërkesën, leja e ndërtimit konsiderohet e dhënë në heshtje. Në rast refuzimi të kërkesës për leje ndërtimi ose kundërshtimi të deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve, vendimi duhet të jetë i arsyetuar.
- **Vendimi i miratimit në heshtje publikohet automatikisht** nga sistemi elektronik në regjistrë. Vendimi i miratimit në heshtje, sipas kërkesës së paraqitur, përbën, së bashku me mandatin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, të vetmet dokumente të nevojshme për fillimin e punimeve.

#### 3. *Përrjashtimi nga zbatimi i parimit të miratimit në heshtje*



- Miratimi në heshtje nuk zbatohet për lejet e ndërtimit që janë në kompetencë të KKT-së, si dhe për punime të tjera, përfshirë ato me rrezikshmëri të lartë, që përcaktohen nga rregullorja e zhvillimit apo rregullohen në mënyrë të veçantë nga legjislacioni në fuqi.

#### **4. Dorëzimi i lejes së ndërtimit**

- Dokumenti i lejes së ndërtimit i dorëzohet kërkuarit të saj nga autoriteti përgjegjës, jo më vonë se:
  - a) **15 ditë** nga data e marrjes së vendimit për miratimin e lejes së ndërtimit nga kryetari i bashkisë;
  - b) **30 ditë** nga data e marrjes së vendimit për miratimin e lejes së ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

#### **5. Afati i lejes së ndërtimit**

- Afati për fillimin e punimeve nuk mund të jetë më i gjatë se 1 vit nga data e miratimit të lejes së ndërtimit.
- Afati i përfundimit të punimeve përcaktohet në bazë të kalendarit të punimeve të miratuar nga autoriteti i planifikimit.

#### **6. Shtyrja e afatit të lejes**

- Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve dhe ndryshimi i subjektit zbatues të përcaktuar në lejen e ndërtimit kryhen nga autoriteti që ka miratuar lejen, me kërkesë të subjektit të pajisur me leje ndërtimi. Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve bëhet vetëm një herë, për një periudhë jo më të gjatë se afati fillestar i përcaktuar në lejen e ndërtimit, mbi bazën e një kërkesë të dorëzuar brenda afatit të vlefshmërisë së lejes dhe, në çdo rast, jo më vonë se 45 ditë përpara përfundimit të afatit të lejes. Kërkesa për shtyrjen e afatit parashtron arsyet për të cilat nuk ka qenë i mundur përfundimi i punimeve brenda afatit dhe shoqërohet nga kalendari i ri i punimeve dhe vërtetimi i pagesës së gjobës për shkeljen e afatit.
- Kërkesa për shtyrjen e afatit të punimeve konsiderohet e miratuar në heshtje nëse autoriteti i planifikimit nuk i njofton vendimin përkatës subjektit kërkuar brenda afatit **45-ditor** nga dita e depozitimit të kërkesës.
- Për përfundimin e punimeve të papërfunduara brenda afatit të përcaktuar, është e detyrueshme pajisja me një leje të re ndërtimi, me përjashtim të rastit kur këto mund të kryhen me deklaratë punimesh mirëmbajtjeje.
- Për punimet e filluara prej më shumë se dhjetë vjetësh dhe ende të papërfunduara, sipas projektit të miratuar, autoriteti përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit përcakton mënyrën e ndërtimit të detyruar ose vendos prishjen apo konfiskimin e ndërtimit.

## ***7. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja***

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja paguhet përpara dorëzimit të dokumentit të lejes së ndërtimit nga autoriteti përgjegjës i planifikimit.

## IV SISTEMI ELEKTRONIK I LEJEVE TË NDËRTIMIT

*Me VKM nr. 271 datë “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 408 datë 13.05.2015” u miratuan shtesat dhe ndryshimet e nevojshme me qëllim krijimin vënien në funksionim dhe përdorimin e Sistemit Elektronik të Lejeve, përmes të cilit do të realizohen elektronikisht procedurat e aplikimit për leje, si dhe procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të këtyre kërkesave.*

- Prej datës **20 Prill 2016**, të gjithë qytetarët dhe profesionistët e licensuar mund të aplikojnë online në portalin e-Albania për t’u pajisur me leje ndërtimi. Për të kryer aplikimin, qytetarët do të regjistrohen në portalin e-Albania duke mundësuar përdorimin e shërbimit të aplikimit online të e-lejeve. Gjatë aplikimit do të realizohet ndërlidhja me institucionet e tjera publike nëpërmjet databazës së ZRPP, QKR, DPGJC në formë automatike për të marrë dhe validuar të dhënat e aplikuesit.
- Sistemi elektronik i lejeve të ndërtimit është gati *online* duke filluar nga data **20 Prill 2016**.
- Nga data **20 Prill 2016** deri më datë **31 Gusht 2016**, qytetarët mund të vijojnë të aplikojnë në të dy mënyrat: *në rrugë elektronike dhe në formë shkresore*. Detyrimi i ngarkimit *on-line* të dosjes së aplikimit është përgjegjësi e këtij autoriteti dhe kryhet menjëherë me paraqitjen e kërkesës në sportel dhe në prani të vetë aplikuesit. Në këtë rast, aplikuesi dorëzon kërkesën për leje dhe dokumentet në letër dhe CD. Në përfundim të ngarkimit në sistem, sporteli i dorëzon aplikuesit numrin e identifikimit të kërkesës, që mundëson ndjekjen e ecurisë së saj.
- Duke filluar nga data **1 Shtator 2016**, aplikimi, shqyrtimi dhe miratimi i lejeve do të kryhet ekskluzivisht përmes sistemit elektronik.
- **Kërkesat e dorëzuara më formë shkresore, deri në datën 31 gusht 2016, do të vijojnë të shqyrtohen nga autoritetet përgjegjëse në formë shkresore**, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi në momentin e aplikimit.

*Sistemi elektronik i lejeve mundëson realizimin e shërbimit me një ndalesë për lejet e ndërtimit (One Stop Shop): aplikimi do t’i dërgohet bashkisë dhe bashkia do të kryejë vetë – përmes sistemit - të gjithë bashkërendimin me institucionet e tjera publike, me afate të qarta dhe pa vonesa (nëse institucionet nuk përgjigjen brenda 10 ditësh, kërkesa konsiderohet e miratuar në heshtje).*

- **Rregulla dhe Afate**

1. Afati i shqyrtimit të lejes së ndërtimit nga bashkia është **15 ditë**, ndërsa institucionet e tjera që duhet të japin mendimin e tyre në lidhje me lejen duhet të përgjigjen **brenda 10 ditëve** pune.
2. Në rast se institucionet publike nuk i japin përgjigje bashkisë **brenda 10 ditëve** pune, miratimi/pëlqimi i tyre konsiderohet i dhënë në heshtje dhe bashkia mund të vijojë më tej me shqyrtimin e aplikimit.
3. Në çdo rast të mungesës së përgjigjes nga bashkia **brenda 60 ditësh** nga dorëzimi i kërkesës së aplikuesi, sistemi gjeneron vendim për miratimin në heshtje.
4. Bashkërendimi me të gjitha institucionet që duhet të japin mendimin e tyre mbi lejen e ndërtimit (p.sh. ZRPP, Shërbimi Arkeologjik, etj.) do të kryhet përmes sistemit elektronik të lejeve nga bashkia përgjegjëse. Mbledhja e tarifave të shërbimit për të gjitha institucionet do të kryhet nga bashkia, si zyrë e shërbimit me një ndalesë, përmes sistemit elektronik.
5. VKM Nr. 408 bën gjithashtu ndarjen mes lejeve të ndërtimit për sipërfaqe deri më 250 m<sup>2</sup> dhe ndërtimeve me sipërfaqe më të madhe se 250m<sup>2</sup>. Për kategorinë e parë (leje ndërtimi për sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup>) janë hequr disa kërkesa të projektit (projekti i instalimeve) si dhe nevoja e mbikqyrjes së punimeve, me kusht që, firma zbatuese të nënshkruajë një deklaratë noteriale për kryerjen e punimeve konform lejes së ndërtimit.

## V PLANET E PËRGJITHSHME VENDORE DHE LEJET E NDËRTIMIT

- Plane të përgjithshme vendore të miratuara kanë Bashkitë e mëposhtme:
  1. Himarë
  2. Lushnjë
  3. Berat
  4. Kamëz
  5. Tiranë
  6. Fier
  7. Vorë
  8. Mamurras
  9. Durrës
  10. Shkodër
  11. Rrogozhinë
  12. Fushë-Krujë
  13. Bulqizë
  14. Korçë
- Këto Bashki mund të vijojnë normalisht me shqyrtimin dhe dhënien e lejeve të ndërtimit, në përputhje me planet vendore përkatëse, për territoret administrative bashkiake përpara reformës territoriale. Në të gjitha zonat e tjera të vendit, deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore në proces hartimi, Bashkitë mund të vijojnë me dhënien e lejeve të ndërtimit për të gjitha objektet e parashikuara në *Vendimin nr. 1, datë 30.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit* duke respektuar kufijtë e zonave të urbanizuara të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.
- Konkretisht, lejet e ndërtimit mund të jepen vetëm për këto raste përjashtimore:
  - 1. Punime të infrastrukturës-** çdo zhvillim i ri, me investim publik ose privat, për ngritje rrjetesh shërbimi ose sigurie publike, të rrjetit elektrik, rrjeteve të ujësjellësit, të kanalizimit, të ngrohjes, të telefonisë, internetit, të kanaleve të kullimit apo kanaleve të ujitjes, leje të sinjalistikës rrugore etj, nga operatorë publik/privat që ofrojnë apo synojnë ofrimin e shërbimeve publike/private sipas legjislacionit në fuqi.
  - 2. Struktura publike**
  - 3. Ndërrhyje me karakter emergjent-** objektet që paraqesin rrezik shembje me pasoja për jetën, shëndetin e njerëzve, pasurinë e të tretëve apo që paraqesin dëmtim

serioz të konstruksionit dhe funksionit të strukturës/ave ekzistuese, objekte që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, të vërtetuara nga raportet teknike të ekspertëve dhe rastet pasojë e forcave madhore apo rasteve të njësuara me to.

4. **Objekte për interes publik, shtetëror dhe kombëtar**- objekte që janë të nevojshme për realizimin e objektivave / interesave të vendit (arsim, shëndetësi, kulturë, ekonomi, ushtri etj.) apo për kryerjen e investimeve strategjike, me mbështetje private ose publike.
5. **Struktura me funksion prodhues, industrialë, përfshirë dhe ato me material porositës** – çdo zhvillim i ri, me investim publik ose privat, nga subjekte publike/private që ofrojnë apo synojnë rritjen e prodhimit industrial në vend, sipas legjislacionit në fuqi.
6. **Struktura me funksion turistik**- sipas rregullave, kriterëve dhe përcaktimeve të legjislacionit sektorial në fuqi në fushën e turizmit;
7. **Struktura në funksion të prodhimit, përpunimit dhe distribucionit të produkteve bujqësore dhe blegtorale** referuar strukturave të përcaktuara në VKM. Nr.283, datë 01.04.2015.
8. **Banesa individuale/njëfamiljare ekzistuese** kërkuar nga pronari i truallit për strehimin primar të tij, me sipërfaqe totale ndërtimi deri në 250 m2.
9. **Banesa individuale/njëfamiljare** ekzistuese deri në masën 50% së tyre totale të ndërtimit.

***Për informacion më të detajuar mund të konsultoni [www.ligjet.org](http://www.ligjet.org) dhe/ose linket e faqeve zyrtare në internet të institucioneve përgjegjëse:***

<http://www.zhvillimiurban.gov.al/al/dokumente/baza-ligjore>  
<http://www.planifikimi.gov.al/?q=sq/content/agjencia-kombetare-e-planifikimit-te-territorit-0>

Kjo përmbledhje përmban informacion të përgjithshëm të marrë nga ligje, akte nën-ligjore apo dokumenta të tjera pjesë e domain-it publik. Informacioni i përfshirë në këtë *Përmbledhje* nuk është shterues dhe nuk zëvendëson asistencën apo këshillimin profesional që mund t'ju duhet Ju apo kompanisë tuaj për të marrë vendime, si edhe nuk duhet të përdoret si bazë për ndonjë vendim ose veprim që mund të ndikojnë financat apo biznesin tuaj. Përpara marrjes së ndonjë vendimi që lidhet me sa më sipër, ju lutem konsultoni legjislacionin përkatës të zbatueshëm në linket zyrtare në brendësi të Përmbledhjes. Sekretariati i Këshillit të Investimeve nuk është përgjegjës mbi saktësinë e këtij informacioni dhe as mbi ndonjë vendim të marrë nga Ju mbi bazën e informacionit të dhënë në këtë Përmbledhje.

*Këshilli i Investimeve, një platformë e mbështetur nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Qeveria Shqiptare për të nxitur dialogun publik – privat në klimën e investimeve në vend. Këshilli i Investimeve mbështetet nga Sekretariati teknik i financuar nga BERZH dhe trajton shqetësimet kryesore të biznesit duke dhënë rekomandime direkte dhe praktike për Qeverinë për ndërhyrje ligjore dhe institucionale për përmirësimin e klimës së të bërit biznes.*